

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8334
E premte, 3 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

ÇFARË PO NDODHË NË SHQIPËRI? (2)



Shkruan: Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTGJYKIMI NDAJ THAÇIT DHE TË TJERËVE MË 16 SHTATOR, PARALAJMËROHEN PROTESTA KUNDËR GJYKATËS SPECIALE

FAQE 4-5



Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë njoftuar se aktgjykimi për katër ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin do të

shpallet më 16 shtator. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së e ka cilësuar shtyrjen e shpalljes së aktgjykimit si të padrejtë dhe të papranueshëm, duke vlerësuar se ky proces është në shërbim të

politikës së Serbisë dhe aleatëve të saj. Edhe PDK-ja ka vlerësuar se Gjykata Speciale po vepron më shumë si një instrument politik sesa si një gjykatë që udhëhiqet nga parimet e drejtësisë

KURTI, HAXHIU DHE GËRVALLA NDEROJNË DELEGATËT E DEKLARATËS KUSHTETUESE F. 7



IKKL-ja PREZANTON VERSIONIN FILLESTAR TË LISTËS PRELIMINARE TË VIKTIMAVE TË LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË F. 7



AKTUALE



MBYLLET AFATI I KATËRT PËR
PËRMBUSHJEN E REFORMAVE NGA
PLANI I RRRITJES, KE DO TË DALË
ME NJË VLERËSIM F. 2

INTELIJENCA ARTIFICIALE PA
KONTROLL NË BALLKANIN
PERËNDIMOR F. 3

ZULFAJ: KOSOVA PRITET T'I HUMBË
MBI 40 MILIONË EURO NGA PLANI I
RRITJES F. 7


EKONOMI



INFRAKOS KËRKON RESPEKTIM
TË BREZIT TË SIGURISË PRANË HEKU-
RUDHËS FUSHË KOSOVË - PEJË F. 8

BASHA TAKON PËRFAQËSUESIT E
AMBASADËS GJERMANE, DISKUTOHEN
PROJEKTET INFRASTRUKTURORE F. 8

SPORT



PRATTIPATI NDEROHET
ME FANELLËN E KOSOVËS
ME NUMRIN 250 NGA FFK-ja F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MBYLLET AFATI I KATËRT PËR PËRMBUSHJEN E REFORMAVE NGA PLANI I RRIJTJES, KE DO TË DALË ME NJË VLERËSIM

BRUKSEL, 2 KORRIK - Dita e fundit e muajit qershor ishte afati përfundimtar në kuadër të periudhës së katërt raportuese për vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i përbushur reformat e parashikuara nga Plani i Rritjes për këto vende. Tani, këto vende kanë afat deri më 15 korrik për t'i dorëzuar raportet mbi hapat e zbatuar të reformave.

Komisioni Evropian (KE) më pas do të vlerësojë përbushjen e tyre dhe do të vendosë për pagesat përkatëse për secilin vend.

Megjithatë, zyrtarët e KE-së theksojnë se të hollat ndahen vetëm pasi të jetë vlerësuar se reformat nga agjendat e reformave të vendeve përkatëse janë zbatuar në të vërtetë. "Instrumenti për reforma dhe rritje bazohet në performancë dhe fondet paguhen vetëm kur reformat zbatohen plotësisht", tha për Radion Evropa e Lirë (REL) zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier. "Tashmë po shohim përparim të rëndësishëm: 78 për qind e reformave në tri rundet e para të raportimit tregojnë ose sukses të plotë, ose të paktën njëfarë përparimi, ndërsa vetëm 22 për qind janë të bllokuara", shtoi zëdhënësi.

Mjetet financiare nga Plani i Rritjes janë të kufizuara në kohë. Nëse vendet përfituese nuk i përbushin kushtet, përkatësisht nuk zbatojnë reformat e parashikuara në agjendat e reformave, Komisioni Evropian ka të drejtë



t'i mbajë fondet e destinuar për këta hapa reformues.

Këto fonde, sipas rregullave të Planit të Rritjes, mund të rishpërndahen te vendet që arrijnë rezultate më të mira në zbatimin e reformave. Sipas Mercier, vendet përfituese kanë një vit kohë për t'i përbushur kushtet përpara se fondet të rishpërndahen. Kosova pritet t'i humbë mbi 40 milionë euro nga Plani i Rritjes për shkak të moszbatimit të reformave me kohë, tha të mërkurën kryenegociatori i Kosovës me BE-në, Jeton Zulfaj.

Përfundimi i periudhës së shtesë

Përveç kësaj, 30 qershori shënoi përfundimin e të ashtuquajturës periudhë "grejs", pra kohës shtesë, që Komisioni Evropian kishte miratuar për hapat reformues që fillimisht duhej të përfundonin në mesin e vitit

2025. Për hapat reformues me afate në fund të 2024 dhe në fund të 2025, periudhat përkatëse shtesë përfundojnë më vonë gjatë vitit 2026. "Siç është theksuar në Rregullore, kur hapat reformues nuk përbushen as pas përfundimit të periudhës së grejsit, fondet përkatëse mund të rishpërndahen te përfituesit e tjerë. Kur bëhet fjalë për hapat me afat 30 qershor 2026, Komisioni tani do të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe objektiv të të gjithë përfituesve", deklaroi zëdhënësi i KE-së.

Ai, në emër të Komisionit Evropian, u bëri thirrje vendeve të rajonit të intensifikojnë përpjekjet në mënyrë që reformat të zbatohen në kohë para periudhave të ardhshme raportuese. "Reformat duhet të mbeten prioritet për përfituesit në mënyrë që të shfrytëzohen sa më shumë mundësitë që ofron Plani i Rritjes", tha Mercier.

Sa para kanë marrë deri tani vendet e Ballkanit Perëndimor?

Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut vlerësohen si shtetet më të përparuar në zbatimin e agjendave të reformave.

Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Evropian, Shqipëria ka zbatuar 33 hapa reformues në tri ciklet e para dhe deri tani ka marrë më shumë se 212 milionë euro nga Plani i Rritjes.

Kosova deri tani nuk ka zbatuar asnjë hap reformues, prandaj ka marrë vetëm fonde të parafinancimit - mbi 61 milionë euro, që përbëjnë 7 për qind të shumës totale të destinuar për këtë vend.

Mali i Zi ka zbatuar 32 hapa reformues, për të cilët i janë paguar gati 90 milionë euro. Maqedonia e Veriut ka marrë më shumë se 142 milionë euro pasi ka përbushur 22 hapa reformues.

Serbia gjatë tre periudhave të

para raportuese ka zbatuar tre hapa reformues, mbi bazën e të cilëve Komisioni Evropian ka miratuar pagesa prej më shumë se 167 milionë euro.

Bosnje e Hercegovina ndodhet në pozitën më të vështirë. Jo vetëm që nuk ka marrë asnjë euro nga Plani i Rritjes, por vitin e kaluar humbi 108 milionë euro për shkak të vonësive në dorëzimin e Agjendës së saj të Reformave.

Sa fonde janë të destinuar për secilin vend?

Buxheti i përgjithshëm i Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor është 6 miliardë euro për periudhën 2024 - 2027. Nga kjo, 2 miliardë janë grante, ndërsa 4 miliardë janë kredi me kushte të favorshme.

Fondet janë shpërndarë sipas dy kriterëve bazë - numrit të popullsisë dhe bruto produktit të brendshëm.

Komisioni Evropian i ka kombinuar këta tregues për të përcaktuar një formulë proporcionale të shpërndarjes midis gjashtë përfituesve, duke siguruar që vendet më të mëdha të marrin më shumë në total, por duke marrë parasysh edhe nevojat e tyre ekonomike.

Sipas këtyre kriterëve, Kosovës i takojnë 882 milionë euro, Serbisë 1.5 miliard euro, Bosnje e Hercegovinës 976 milionë euro, Shqipërisë 922 milionë euro, Maqedonisë së Veriut 750 milionë euro dhe Malit të Zi 383 milionë euro.

Rusia e godet Kievin me raketa dhe dronë, të paktën 17 të vrarë

KIEV, 2 KORRIK - Rusia e ka goditur kryeqytetin ukrainas në një nga sulmet e saj më të mëdha me dronë dhe raketa këtë vit, duke i vrarë të paktën 17 njerëz. Ky sulm vuri në pah përpjekjet e vazhdueshme të Moskës për të gjujzuar Kievin me bombardime të vazhdueshme.

Sulmi i së enjtes ndodhi në mes sulmeve javore me dronë ukrainas mbi rafineritë e naftës ruse, një fushatë që ka shkaktuar mungesa karburanti në mbarë Rusinë dhe ka nxitur pakënaqësi mes rusëve të shkëputur nga lufta në Ukrainë, e cila tashmë është në vitin e saj të pestë.

Ushtria ruse tha se sulmi ishte përgjigje ndaj "sulmeve

terroriste" kundër "infrastrukturës civile" ruse. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, deklaroi se Moska synon ta rrisë tryshninë ndaj Kievit për t'i arritur synimet e luftës.

"Rusia i lëshoi më shumë se 70 raketa të llojeve të ndryshme kundër Ukrainës gjatë natës, pothuajse gjysma e tyre raketa balistike, së bashku me gati 500 dronë sulmues", shkroi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky në një postim në X. Zjarrfikësit shuan zjarre në disa lokacione, ndërsa ekipet e shpëtimit po gërmojnë nën rrënoja në kërkim të të mbijetuarve.

Autoritetet e Kievit thanë se të paktën 17 njerëz janë

konfirmuar të vdekur, ndërsa numri i viktimave pritet të rritet. Dhjetëra të tjerë janë plagosur në sulme.


Sipas Shërbimit Shtetëror të Emergjencave të Ukrainës, në disa lagje të qytetit u raportuan zjarre dhe dëme të mëdha në infrastrukturën civile dhe ndërtesat e banimit. "Në zonat e prekura janë angazhuar 570 shpëtimtarë dhe mbi 125 mjete të specializuara të shpëtimit", thuhet në një njoftim të shërbimit në Telegram.

Korrespondenti i Radios Evropa e Lirë, Maryan Kushnir, raportoi nga vendngjarja, duke treguar pasojat e sulmit të kryer gjatë natës ndaj një ndërtese banimi në lagjen Shuliavka të Kievit.

Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Andriy Sybiha, i ka dënuar ashpër sulmet ruse, duke i cilësuar ato si "krime të rënda luftime" dhe u ka bërë thirrje partnerëve dhe organizatave ndërkombëtare për "përgjigje të fuqishme". "Krimineli i luftës, Putin, është në gjendje të zhvillojë vetëm luftë të ulët dhe terroriste kundër civilëve, grave dhe fëmijëve", shkroi Sybiha në një postim në X.

Në mbrëmje para sulmit, Zelensky paralajmëroi për "një tjetër sulm masiv rus", duke iu referuar informacioneve të inteligjencës.

Ai tha se po kthehej "menjëherë" në Ukrainë nga Irlanda, ku ndodhej për një



vizitë zyrtare.

Autoritetet e Kievit thanë se të paktën 17 njerëz janë konfirmuar të vdekur, ndërsa numri i viktimave pritet të rritet. Dhjetëra të tjerë janë plagosur në sulme. Nga ana e saj, Ukraina vazhdoi fushatën e saj në zgjerim me dronë gjatë natës, duke lëshuar më shumë se 330 dronë drejt shënjestrave në rajonet e Moskës dhe Leningradit.

Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, e shpalli ditë zie të premtën.

INTELIJENCA ARTIFICIALE PA KONTROLL NË BALLKANIN PERËNDIMOR

PRISHTINË, 2 KORRIK - "Unë jam asistenti juaj virtual. Mirë se vini!" Ky është mesazhi me të cilin qytetarët në Ballkanin Perëndimor përballen gjithnjë e më shpesh kur vizitojnë faqet zyrtare të institucioneve ose bankave.

Në vend të një punonjësi, pyetjeve të tyre u përgjigjen chatbotë, ose asistentë virtualë, të bazuar në inteligjencën artificiale (IA).

Megjithatë, përdorimi i teknologjive si kjo ende nuk është i rregulluar qartë me ligj.

Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia ndodhen në faza të ndryshme të zhvillimit dhe përdorimit të inteligjencës artificiale, veçanërisht në administratën publike.

Përgjigjet e institucioneve shtetërore, të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregojnë se shumica nuk kanë rregulla të qarta nëse nëpunësit publikë lejohen të përdorin mjete të inteligjencës artificiale, si ChatGPT, Copilot apo Gemini, gjatë kryerjes së punës së tyre.

Po ashtu, shumica e institucioneve nuk mbajnë evidencë se sa dhe si përdoren këto mjete.

Në disa raste mungojnë edhe masat teknike që do të parandalonin futjen e dokumenteve zyrtare ose të dhënave personale të qytetarëve në platformat e inteligjencës artificiale.

Disa institucione e pranojnë se punonjësit e tyre e përdorin inteligjencën artificiale për të hartuar dokumente, për të përkthyer tekste, për të korrigjuar shkrime, për të kryer detyra administrative, për të analizuar sasi të mëdha të të dhënave ose për të kërkuar informacione.

Të tjerat thonë se një praktikë e tillë nuk përdoret.

Por, pavarësisht kësaj, gati të gjitha pajtohen se mungon një kuadër i posaçëm ligjor për përdorimin e inteligjencës artificiale dhe se rreziqet më të mëdha lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.

Sipas tyre, përgjegjësia për çdo keqpërdorim të dokumenteve ose të të dhënave e mban vetë personi që përdor mjetet e inteligjencës artificiale.

"Përdorimi i inteligjencës artificiale nuk mund të ndalohet. Është njësoj sikur dikush të më ndalonte të përdor një nga gjuhët që di. Por, ai mund të rregullohet me ligj", thotë për Radion Evropa e Lirë eksperti gjyqësor i teknologjisë së informacionit në Bosnje dhe Hercegovinë, Enes Çengiq.

Ai paralajmëron se përdoruesit duhet të jenë të kujdesshëm me informacionin që fusin në platformat e inteligjencës artificiale, pasi, sipas tij, të dhënat e futura në këto sisteme mund të ruhen në serverë dhe, në rrethana të caktuara, të rikuperohen edhe më vonë.

Mjetet e inteligjencës artificiale, pa rregulla të qarta përdorimi

Ndërsa vendet anëtare të Bashkimit Evropian tashmë kanë nisur zbatimin e Aktit për Inteligjencën Artificiale (AI Act), vendet e Ballkanit Perëndimor

janë ende në fazën e hartimit të ligjeve, strategjive dhe udhëzimeve për përdorimin e inteligjencës artificiale, si dhe të përafritimit të tyre me rregullat e BE-së.

Bosnje dhe Hercegovina nuk ka ende ligj që e rregullon përdorimin e inteligjencës artificiale, sidomos në institucionet shtetërore.

Një ligj i tillë, madje, nuk është hartuar as në formë drafti.

Nga përgjigjet që Radio Evropa e Lirë ka marrë nga disa institucione shtetërore, rezulton se disa prej tyre kanë vërejtur se punonjësit ose nuk përdorin fare mjete të inteligjencës artificiale, ose i përdorin në masë të kufizuar. Kur përdoren, ato shërbejnë kryesisht për hartimin e teksteve, përkthime, korrektim gjuhësor dhe detyra administrative.

Të gjitha institucionet që janë përgjigjur, pranojnë se Bosnje dhe Hercegovina nuk ka një kornizë të përbashkët ligjore për përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale në administratën publike.

Ato kërkojnë miratimin e rregullave të përafraura me standardet e Bashkimit Evropian. Prokuroria e Bosnje dhe Hercegovinës, për shembull, thotë se punonjësit mund t'i përdorin vetëm ato mjete të inteligjencës artificiale që janë miratuar nga shërbimi i teknologjisë informative i institucionit.

Këto mjete mund të përdoren për përpunim tekstesh, përkthime ose gjenerim idesh.

Punonjësit e Prokurorisë u ndalohet të fusin në sisteme publike të inteligjencës artificiale të dhëna personale të qytetarëve, të dhëna nga lëndët penale, sekrete zyrtare, draftet e akteve të papublikuara ose informacione të tjera konfidenciale.

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës thotë se, për rreth 50 ministri dhe agjenci, aktualisht ofron rekomandime profesionale për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të mjeteve të inteligjencës artificiale, sidomos për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike.

Nga ky sekretariat theksojnë se për hartimin e kornizës së ardhshme ligjore, përgjegjëse është Ministria e Komunikimeve dhe Transportit e Bosnje dhe Hercegovinës.

Kjo ministri konfirmon për Radion Evropa e Lirë se po punon në një plan për përafritimin e rregullave me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Bosnje dhe Hercegovinës thotë se përdorimi i inteligjencës artificiale në përpunimin e të dhënave, nuk është i rregulluar veçmas me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sipas saj, rregullimi i përdorimit të mjeteve të inteligjencës artificiale në administratën publike nuk është në kompetencën e kësaj agjencie.

Megjithatë, agjencia thekson se institucionet që përpunojnë të dhëna personale, duhet të zbatojnë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për mbrojtjen e tyre. Ato duhet të vlerësojnë edhe rreziqet e çdo përpunimi të të dhënave,

përfshirë rastet kur përdoren mjete të inteligjencës artificiale. Shumica e kompetencave në Bosnje dhe Hercegovinë janë në nivelin e dy entiteteve, administrata e të cilave numëron rreth 28 mijë zyrtarë.

Megjithatë, as Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, as Republika Srpska nuk kanë rregulla të posaçme që do ta rregullonin në hollësi përdorimin e inteligjencës artificiale në sektorin publik.

Agjencia për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit e Republikës Srpska konfirmon për Radion Evropa e Lirë se disa institucione tashmë përdorin mjete digjitale me elemente të inteligjencës artificiale, për analizimin e të dhënave dhe automatizimin e proceseve administrative.

Qeveria e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës nuk iu përgjigji pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për këtë çështje.

Ndërsa disa institucione, si Agjencia e Prokurimit Publik e Bosnje dhe Hercegovinës, po zhvillojnë chatbotë, sektori privat - përfshirë bankat dhe zinxhirët e mëdhenj tregtarë - tashmë i përdor këto mjete.

Zakonisht, ato zhvillohen në bashkëpunim me platforma komunikimi, si Viber ose WhatsApp.

Modernizimi i shërbimeve në Kosovë

As Kosova nuk ka ligj të posaçëm që rregullon përdorimin e inteligjencës artificiale në administratën publike.

Strategjia për e-qeverisje 2023-2027 parashikon përfshirjen e zgjidhjeve të avancuara digjitale - mes tyre: mjetet e inteligjencës artificiale dhe analizën e sasive të mëdha të të dhënave, si pjesë e procesit të digjitalizimit të shërbimeve publike.

Në praktikë, tashmë po testohen disa zgjidhje të tilla si platforma e-Kosova 2.0 dhe projektet në Administratën Tatimore të Kosovës, të cilat synojnë t'i automatizojnë proceset dhe t'u ofrojnë qytetarëve shërbime më të shpejta dhe më të personalizuar.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës thotë për Radion Evropa e Lirë se punonjësit e saj nuk përdorin asnjë mjet të inteligjencës artificiale në punën hetimore, administrative apo mbështetëse.

Institucionet e Kosovës, ndërkohë, thonë se po punojnë për t'i përafuruar rregullat me standardet e Bashkimit Evropian. Gjatë vitit 2026 ka nisur edhe një vlerësim i gatishmërisë së Kosovës për t'u harmonizuar me Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale (AI Act) dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).

Krenara Sogojeva Dermaku, komisionare e Agjencisë për Informim dhe Privatësi në Kosovë, thotë për Radion Evropa e Lirë se Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk përmban rregulla të veçanta për rastet kur të dhënat personale mund të ekspozohen ose keqpërdoren përmes mjeteve të inteligjencës artificiale.

Sipas saj, çdo keqpërdorim i të dhënave trajtohet sipas rregullave të përgjithshme të ligjit, pavarësisht nëse përfshin ose jo



inteligjencën artificiale.

Ajo rikujton se Kosova është anëtare e Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave, ku qytetarët dhe institucionet mund të drejtohen në rast se të dhënat e tyre keqpërdoren.

Ministria e Digjitalizimit e Kosovës, Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk iu përgjigjën kërkesave të Radios Evropa e Lirë për koment.

Mali i Zi dhe Serbia përfshijnë inteligjencën artificiale në shërbimet publike

Krahasuar me Kosovën dhe Bosnje dhe Hercegovinën, Mali i Zi dhe Serbia kanë avancuar më shumë në përdorimin e inteligjencës artificiale në administratën publike.

Mali i Zi nuk e ka harmonizuar ende plotësisht legjislacionin e tij me Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale, por ky proces është pjesë e detyrimeve që ky vend ka në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se po përgatit një kornizë të rregullave për të rregulluar përdorimin e inteligjencës artificiale dhe për të parandaluar keqpërdorimin e saj.

Qeveria, ndërkohë, ka nisur hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Inteligjencës Artificiale 2026-2030.

Ministria e Administratës Publike thotë për Radion Evropa e Lirë se Mali i Zi, në bashkëpunim me Bankën Botërore, po harton një plan për zhvillimin e inteligjencës artificiale si pjesë e transformimit digjital të sektorit publik.

Në fushën e sigurisë kibernetike, Mali i Zi ka miratuar një ligj të ri të harmonizuar me Direktivën NIS2 të Bashkimit Evropian, e cila përcakton standarde të detyrueshme për mbrojtjen e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Po ashtu, janë krijuar qendra operative për monitorimin e infrastrukturës digjitale.

Serbia, në anën tjetër, ka nisur ta përdorë inteligjencën artificiale në disa shërbime publike, edhe pse ende nuk ka një ligj që rregullon zhvillimin dhe përdorimin e saj.

Asistentë virtualë, apo chatbotë, janë të disponueshëm në faqet e internetit të Administratës Tatimore, Agjencisë për Regjistrat e Bizneseve dhe portalit e-Uprava, ku u përgjigjen pyetjeve të qytetarëve dhe i ndihmojnë ata të përdorin shërbimet elektronike.

Por, këto sisteme kanë edhe kosto. Sipas një analize të bazës së të dhënave të prokurimit publik, të kryer nga Radio Evropa e Lirë, vetëm asistenti virtual i Administratës Tatimore i ka kushtuar shtetit rreth 196 mijë euro gjatë vitit 2026.

Asnjë prej institucioneve që i përdorin këto sisteme, nuk iu

përgjigji pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se si mbrohen të dhënat personale që qytetarët mund t'i ndajnë gjatë komunikimit me chatbotët.

Aktualisht, Serbia mbështetet në Strategjinë për Zhvillimin e Inteligjencës Artificiale 2025-2030 dhe në Udhëzimet Etike për Zhvillimin dhe Përdorimin e Inteligjencës Artificiale, por këto dokumente nuk kanë fuqi detyruese ligjore.

Komisionari për Informim me Rëndësi Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se vendit i nevojitet një ligj i posaçëm për të rregulluar mbikëqyrjen e sistemeve të inteligjencës artificiale, mbrojtjen e qytetarëve dhe ndalimin e përdorimeve me rrezik ose diskriminuese.

"Për shkak se përdorimi masiv i këtyre sistemeve në Serbi ende nuk është i përhapur dhe mungon një kornizë e qartë ligjore, deri më tani nuk kemi pasur një numër të madh procedurash formale të inspektimit", thonë nga ky institucion për Radion Evropa e Lirë.

Projektligji i posaçëm, i harmonizuar me Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale, është ende në hartim, ndërsa miratimi i tij pritet deri në fund të vitit 2026.

"Projektligji është harmonizuar me Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale", thotë për Radion Evropa e Lirë Irena Gjorgjeviq nga Aleanca Kombëtare për Zhvillim Ekonomik Lokal (NALED) - organizatë që është pjesë e grupit punues për hartimin e këtij ligji.

Sipas Gjorgjeviqit, projektligji parashikon që sistemet dhe modelat e inteligjencës artificiale të klasifikohen sipas nivelit të rrezikut që paraqesin. "Do të ketë sisteme të ndaluar, të cilat nuk do të lejohen fare në treg, sisteme me rrezik të lartë, me rrezik mesatar dhe me rrezik minimal.

Ligji do të zbatohet si për zhvilluesit vendas, ashtu edhe për ata të huaj të sistemeve dhe modeleve të inteligjencës artificiale", thotë ajo.

Ana Toskiq Cvetinoviq, nga organizata joqeveritare Partneri Srbija, paralajmëron se projektligji përmban disa përjashtime të diskutueshme.

Një prej tyre është përjashtimi i sektorit të mbrojtjes nga zbatimi i ligjit.

Ajo shton se, aktualisht, nuk ekziston një evidencë zyrtare për mjetet e inteligjencës artificiale që përdoren nga institucionet shtetërore dhe as rregulloren të brendshme që përcaktojnë mënyrën e përdorimit të tyre, megjithëse, sipas saj, mjete si ChatGPT tashmë përdoren në sektorin publik.

Eksperti gjyqësor i teknologjisë së informacionit, Enes Çengiq, thotë se përdorimi i inteligjencës artificiale si mjet pune është i dobishëm, sepse e përshpejton ndjeshëm punën.

Por, ai thekson se intelijenca artificiale gabon dhe se përgjegjësia për rezultatit përfundimtar mbetet gjithmonë te njeriu që e përdor.

Për të ilustruar rrezikun e keqpërdorimit, ai sjell këtë shembull: "Është njësoj sikur dikush të shkruajë një punim doktorature për romanin Ura mbi Drin, pa e lexuar kurrë librin".



AKTGJYKIMI NDAJ THAÇIT DHE TË TJERËVE MË 16 SHTATOR, PARALAJMËROHEN PROTESTA KUNDËR GJYKATËS SPECIALE

Ministrja në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka theksuar të mërkurën se, pas certifikimit të rezultateve, pritet të nisë komunikimi zyrtar ndërmjet partive për krijimin e institucioneve të reja. Sipas saj, mospajtimet dhe qëndrimet e ndryshme brenda partive mund ta vështirësojnë konstituimin e institucioneve dhe arritjen e një dakordimi ndërmjet subjektit fitues të zgjedhjeve dhe partive të tjera, ndërsa ka theksuar se projektet strategjike nuk duhet të përdoren për përplasje politike

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë njoftuan të mërkurën se aktgjykimi për katër ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin do të shpallet më 16 shtator të këtij viti.

Në një njoftim për media, gjykata tha se trupi gjykues ka caktuar datën për shqiptimin e aktgjykimit për 16 shtator 2026, në orën 10:00. "Trupi Gjykues shpjegoi se koha e nevojshme për kuvendimet ishte zgjatuar në përputhje me Rregulloren, për shkak të

vëllimit të madh të provave të marra dhe kompleksitetit të procesit gjyqësor, dhe se kjo zgjatje përlligje nga nevoja për të bërë një vlerësim të arsyetuar, tërësor dhe të drejtë të dokumentacionit të çështjes", thuhet në njoftim. Fillimisht, Trupi Gjykues kishte afat deri më 19 maj për të shpallur vendimin. Por, duke u thirrur në kompleksitetin e rastit, ai vendosi ta shtynte këtë afat deri më 20 korrik 2026 dhe tani vendosi përfundimisht për 16 shtator.

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së caktimin e 16 shtatorit si raundin e radhës të poshtërimin publik ndaj Hashim Thaçit, Kadri

Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit; e konsideron të padrejtë dhe të papranueshëm. "Shtyrjet e njëpasnjëshme, të maskuara si përgjigje ndaj vëllimit dhe kompleksitetit, vërtetojnë atë që kemi theksuar që në fillim: ky proces është thjesht në shërbim të politikës së Serbisë dhe aleatëve të saj, me qëllim që ta ulë në bankën e të akuzuarve Luftën Çlirimtare, ndërkohë që amnistion makinerinë gjenocidiale të shtetit fashist serb, duke e shpëtuar nga llogaridhënia. Asnjë kalendar gjyqësor nuk e rishkruan themelin e lirisë së Kosovës, luftën e drejtë për mbijetesë. Misionin që dikur e kishte EULEX, po e vazhdon me besnikëri Haga, ndërkohë që qasja e disa qarqeve ndërkombëtare, që shpesh deklarohen si partnere të Kosovës, ka krijuar barriera të vazhdueshme ndaj vlerave të Luftës Çlirimtare dhe ka penguar zhvillimin e plotë të vendit tonë. Kjo situatë nuk mund të tolerohet më. Rezistenca jonë do të zhvendoset në rrugë përmes protestave, duke mos përjashtuar mundësinë e përshkallëzimit të tyre nëse zëri ynë vazhdon të injorohet", është thënë në reagimin e

OVLUÇK-së.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se shtyrja e përsëritur e afatit për vendimin përfundimtar në rastin kundër ish-udhëheqësve të UÇK-së vetëm sa e rikonfirmon se Gjykata Speciale në Hagë po vepron më shumë si një instrument politik sesa si një gjykatë që udhëhiqet nga parimet e drejtësisë. "Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po vazhdojnë të mbahen peng të këtij procesi të padrejtë dhe të pafund. Paraburgimi i stërzgatur u është shndërruar atyre në një dënim të padrejtë dhe Gjykata Speciale, përveç se e ka humbur besimin tonë dhe e ka devijuar misionin e saj, po e thëllon gjithnjë e më shumë edhe pakënaqësinë e qytetarëve në Kosovë. Çdo ditë e një procesi të padrejtë është e papranueshme dhe 16 shtatori është datë e largët për t'i dhënë fund kësaj padrejtësie", ka thënë Hamza. Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka reaguar lidhur me procesin gjyqësor në Dhomat e Specializuara, duke deklaruar se, sipas tij, përveç pafajësisë së plotë të të

akuzuarve, nuk duhet të pranohet asnjë vendim që ai e konsideron politik.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Mahmuti rikujtoi letrën që ua kishte dërguar deputetëve të Kuvendit të Kosovës më 14 maj 2015, ku kishte paralajmëruar se krijimi i Dhomave të Specializuara, të mbështetura në Raportin e Dick Martyt, paraqiste rrezik për luftën çlirimtare të Kosovës.

Ai iu referua edhe deklarimeve të juristit britanik Geoffrey Nice, i cili, sipas Mahmutit, ka vlerësuar se Gjykata Speciale "pasqyron objektiva të fshehta politike".

Gjithashtu, Mahmuti përmendi edhe një postim të avokatit Luka Misiq, sipas të cilit Paneli i Apelit i Dhomave të Specializuara ka miratuar të gjitha apelimet e Prokurorisë dhe ka refuzuar të gjitha apelimet e mbrojtjes të shqyrtuara deri më tani.

Në fund të reagimit, Mahmuti u bëri thirrje institucioneve të Kosovës dhe shqiptarëve që të mbajnë një qëndrim të qartë ndaj procesit, duke theksuar se, sipas tij, "përveç pafajësisë së plotë, nuk do të pranojmë asnjë vendim politik nga institucionet e drejtësisë".

Hashim Thaçi, Kadri Veseli,

HAMZA BISEDON NË TELEFON ME THAÇIN: MË 16 SHTATOR DREJTËSIA DO TË VIHET NË VEND, TË FALA NGA PRESIDENTI



PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka bërë të ditur se ka zhvilluar një bisedë telefonike me ish-presidentin Hashim Thaçi, me të cilin ka diskutuar për Kosovën, familjet, miqtë dhe qytetarët që, sipas tij, nuk kanë reshtur së besuari në rikthimin e ish-krerëve të

UÇK-së. Hamza ka thënë se gjatë bisedës është folur edhe për pritjen e gjatë të përfundimit të procesit gjyqësor në Hagë, duke vlerësuar se vonesat e vazhdueshme në shpalljen e aktgjykimit e kanë rënduar edhe më shumë këtë pritje. "Drejtësia mund të vonohet,

por nuk duhet të tjetërsohet", ka theksuar Hamza, duke shprehur bindjen se më 16 shtator drejtësia do të vihet në vend dhe presidenti Thaçi, së bashku me bashkëluftëtarët e tij, do të kthehen të lirë në Kosovë.

Kreu i PDK-së, gjatë bisedës i ka përcjellë ish-presidentit

Thaçi përsëritjet, mbështetjen dhe pritjet e qytetarëve të Kosovës, ndërsa ka bërë të ditur se edhe ish-presidenti Thaçi ka kërkuar që përsëritjet e tij më të përzemërta t'u përcillen të gjithë qytetarëve. "Me qetësinë dhe besimin që e karakterizon, bisedën e

përfunduar me shpresën se shumë shpejt do të shihemi në Kosovë", ka shkruar Hamza.

Në fund të reagimit të tij, kryetari i PDK-së ka përsëritur mesazhin: "Dielli do të lindë përsëri! Për çlirimtarët, për historinë tonë të lavdishme dhe për Kosovën!".

Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi kanë mohuar akuzat e ngritura nga Specialja dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Prokurorët kanë kërkuar që ata të shpallen fajtorë dhe secili të dënohet me nga 45 vjet burgim për krimet e pretenduara.

Mbi 130 dëshmitarë dëshmuar, ndërsa u pranuar me shkrim 160 deklaratatë të dëshmitarëve të tjerë në këtë gjyq gjatë tri vjetëve seanca.

Gjyqi ndaj tyre përfundoi në shkurt, ndërsa ata janë mbajtur në paraburgim në Hagë qëkurse u arrestuan në vitin 2020.

Gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së ka hasur në kundërshtime të shumta në Kosovë, pasi është parë si e njëanshme, duke qenë se në të nuk përfshihen krimet e kryera nga serbët në territorin

e Kosovës.

Prej atëherë, nëpër Kosovë janë vendosur pankarte e pllakate të mëdha me mesazhin "Liria ka emër" dhe fotografi të ish-krerëve të UÇK-së.

Gjithashtu ka pasur protesta kundër këtij procesi në Hagë, në Prishtinë dhe në qytete të tjera.

Mijëra qytetarë morën pjesë në protestën "Drejtësi, jo politikë" në Ditën e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt këtë vit në Prishtinë, në përkrahje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

Profesori amerikan, Daniel Serwer në një intervistë për "Ekonomia Online" ka folur lidhur me procesin gjyqësor në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai u shpreh se është penduar që ka mbështetur krijimin e

Dhomave të Specializuara, pasi që sipas tij mbajtja në paraburgim e katërshes së UÇK-së, si para fillimit të gjykimit ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor për kohë të gjatë është e pajustificuar.

Ai përmendi ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, për të cilin tha se nuk ka pasur autoritet komandues mbi UÇK-në. "Sigurisht që nuk e kam idenë se çfarë vendimi do të marrin. Ajo që do të thosha është se pendohej që e kam mbështetur krijimin e këtyre Dhomave të Specializuara, sepse mendoj se paraburgimi i gjatë, si para fillimit të gjykimit ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor, ka qenë i pajustificuar sipas mendimit tim. Nuk di ndonjë rrethanë që do ta justifikonte këtë, por nuk jam jurist dhe do të më duhet të pranoj çfarëdo vendimi që

ata të marrin. Ndjenja ime e fortë, veçanërisht sa i përket Hashim Thaçit, sepse e njoh atë dhe e njoh më mirë rolin e tij sesa të të tjerëve, është se ai nuk ka pasur autoritet komandues mbi UÇK-në. Prandaj, mbajtja e tij përgjegjëse mbi këtë bazë do të ishte një gabim i rëndë", ka theksuar Serwer.

Një raport i organizatës britanike "The Bar Human Rights Committee of England and Wales (BHRC)", që u paraqitur së fundmi në Prishtinë nga Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ngre pikëpyetje serioze mbi mënyrën se si po zhvillohet procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Dhomat e Specializuara në Hagë. Ky dokument, i përqendruar ekskluzivisht në proceset gjyqësore ndaj ish-

krerëve të UÇK-së, konsiderohet ndër analizat më kritike të deritanishme për këtë gjykatë. Gjithashtu ngre pikëpyetje për strukturën e vet gjykatës, e cila përbëhet vetëm nga gjyqtarë ndërkombëtarë, pa përfshirje të ekspertizës vendore, si dhe për paqartësi në aplikimin e ligjit dhe mungesë transparence.

Avokati i Popullit, Naim Qelaj, në prezantimin e raportit ka theksuar se gjatë proceseve gjyqësore ndaj ish-krerëve të UÇK-së janë evidentuar shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Qelaj ka bërë me dije se raporti konfirmon shqetësimet e ngritura më herët, duke i cilësuar ato si serioze dhe të mjaftueshme për një shqyrtim të mëtejshëm institucional.

Përrurohet shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova në Klinë

KLINË, 2 KORRIK - Në Klinë të enjten është përruroar shtatorja e ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova. Aty morën pjesë familjarë të Rugovës, kryetarë partish, ish-presidentja Vjosa Osmani, deputetë dhe qytetarë. Kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, ka thënë se sot qyteti i Klinës

jo vetëm që po pasurohet me një vepër monumentale, por po fiton një simbol të kujtesës, identitetit dhe vlerave mbi të cilat është ndërtuar shteti ynë. "Ky vend, që nga sot mban emrin Sheshi "Ibrahim Rugova", nuk do të jetë vetëm një hapësirë publike. Ai do të jetë vend kujtese, reflektimi

dhe edukimi qytetar. Kjo shtatore që sot po përrurohet është më shumë se një vepër artistike. Ajo është shenjë respekti dhe mirënjohjeje për një burrë shteti që në kohët më të vështira zgjodhi rrugën e mençurisë, dialogut dhe rezistencës paqësore. Në emrin tim dhe të qytetarëve të

Klinës, shpreh mirënjohje për donatorët, Marjan dhe Ilir Cubi, të cilët e mundësuan realizimin e kësaj shtatoreje, një kontribut me vlerë të veçantë për kujtesën tonë historike dhe për pasurimin e hapësirës publike të qytetit tonë. I përjetshëm qoftë kujtimi për presidentin



historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova!", ka thënë Elezaj.

IKKL-ja PREZANTON VERSIONIN FILLESTAR TË LISTËS PRELIMINARE TË VIKTIMAVE TË LUFTËS SË FUNDIT NË KOSOVË

PRISHTINË, 2 KORRIK - Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka prezantuar versionin fillestar të listës preliminare të viktimave të luftës së fundit në Kosovë, në prani të kryeministrit në detyrë Albin Kurti, si dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, akademisë, sistemit të drejtësisë, ekspertëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Gjatë takimit u prezantuan metodologjia e ndjekur për ndërtimin e databazës, burimet e përdorura, procesi i

harmonizimit të të dhënave, si dhe rezultatet e punës së deritanishme të Institutit në dokumentimin e viktimave të luftës. Takimi u zhvillua në frymë konsultimi profesional dhe kishte për qëllim diskutimin, plotësimin dhe verifikimin e mëtejshëm të të dhënave, si hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një evidence shtetërore të saktë, të besueshme dhe metodologjikisht të verifikuar për viktimat e luftës në Kosovë (1998 - 1999). IKKL-ja ka shprehur mirënjohje



për pjesëmarrjen, kontributin dhe komentet profesionale të të gjithë të pranishmëve, të cilat do të kontribuojnë në avancimin e mëtejshëm të këtij zhvillimi. Procesi do të vazhdojë edhe në fazat e ardhshme, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet, ekspertët, organizatat dhe familjarët e viktimave, me synimin që databaza të plotësohet dhe të përditësohet vazhdimisht, në përputhje me mandatin ligjor të IKKL-së dhe standardet më të larta profesionale.

KONFERENCA RAJONALE NË PRISHTINË, TAHIRI: FUQIZIMI I GRAVE ËSHTË KYÇ PËR PAQE TË QËNDRUESHME DHE INTEGRIM EVROPIAN

PRISHTINË, 2 KORRIK - Konferenca Rajonale e Dialogut për Paqen, "Ndërtimi i Paqes: Gratë Udhëheqin Pajtimin në Ballkanin Perëndimor", u mbajt më 29-30 qershor 2026, në Prishtinë, Kosovë, e organizuar nga Lobi Rajonal i Grave në Evropën Juglindore (RWLSEE) nën udhëheqjen time dhe e mbështetur nga UNMIKU. Konferenca ofroi një platformë strategjike dialogu - dialog shumëdimensional - ndërkufitar, ndëretnik dhe ndërgjeneracional.



Kjo konferencë rezultoi shumë e suksesshme dhe me shumë njohuri mbi pajtimin, ndërtimin e paqes, fuqizimin e

grave dhe të rejave për paqe të qëndrueshme dhe integrimin evropian të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Pjesëmarrëset, gra dhe gra të reja udhëheqëse të politikës, parlamentare, ndërtuese të paqes, qytetare nga të shtatë vendet e fokusuar, nga Kroacia, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, u angazhuan në diskutime, me një frymë të gjallë dhe paqedashëse për të kapërcyer ndarjet, për të

forcuar besimin ndëretnik, për drejtësinë tranzicionale për paqe të qëndrueshme në rajon me qëllim që rajoni të kalojë nga paqja e brishtë në një paqe të qëndrueshme me rolin kryesor udhëheqës të grave. Një komponent i dytë, "Formësimi i Paqes Së Bashku", u përqendrua në dialogun ndërgjeneracional dhe fuqizimin e grave dhe të rinjve të rinj përmes seminareve dhe shkëmbimeve që synojnë avancimin e axhendave të Grave, Paqes dhe Sigurisë

(WPS) dhe të Rinjve, Paqes dhe Sigurisë (YPS). Politikanja Edita Tahiri ka vlerësuar lartë fuqinë e grave dhe vajzave të reja për t'iu drejtuar me zemër të hapur trashëgimive të luftës dhe për të arritur qëllimet e pajtimit ndëretnik, drejtësisë tranzicionale dhe ndërtimit të paqes si procese gjithëpërfshirëse për paqe të qëndrueshme dhe të ardhme evropiane dhe euroatlantike të vendeve në Ballkanin Perëndimor.

FATON PECI PREZANTON PUNËN GJASHTËMUJORE PARA QYTETARËVE TË MITROVICËS

MITROVICË, 2 KORRIK - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faton Peci, ka mbajtur takim publik me qytetarët për prezantimin e punës gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2026. Në këtë takim morën pjesë nënkryetari, Enis Osmani, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të lagjeve dhe

fshatrave, qytetarë, si dhe pjesëmarrës të tjerë. Gjatë takimit u prezantuan punët, të arriturat dhe projektet e realizuara gjatë kësaj periudhe, projektet që janë në proces të zbatimit, si dhe ato që pritet të nisnin së shpejti. Kryetari Peci falënderoi të gjithë qytetarët për pjesëmarrjen e

konsiderueshme, për vlerësimin e punëve të kryera, si dhe për propozimet, kërkesat dhe kritikën konstruktive të paraqitura gjatë diskutimit. Ai theksoi se qeverisja e mirë lokale bëhet vetëm në bashkëpunim me qytetarët, dhe se do të vazhdojë konsultimet me ta për interesin publik.



Latifi: Qeveria ende nuk ka kompensuar dëmet nga fatkeqësitë natyrore, Rahoveci pret rreth 4 milionë euro

RAHOVEC, 2 KORRIK - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka ngritur shqetësimin për vonesat në kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore gjatë viteve 2022, 2023, 2024, 2025

dhe 2026. Përmes një postimi në "Facebook", Latifi ka pyetur pse Qeveria e Kosovës ende nuk ka nisur kompensimin e dëmeve, duke theksuar se shumë familje, fermerë dhe

biznese vazhdojnë të presin mbështetjen e premtuar. Sipas tij, vlera e dëmeve të regjistruara ndër vite në Komunën e Rahovecit arrin në rreth 4 milionë euro. "Qytetarët kanë të drejtë të

dinë pse po vonohet ky proces dhe kur do të ketë një zgjidhje konkrete", ka shkruar Latifi, duke kërkuar sqarime nga institucionet qendrore për vonesat në kompensimin e dëmeve.



KURTI, HAXHIU DHE GËRVALLA NDEROJNË DELEGATËT E DEKLARATËS KUSHTETUESE TË 2 KORRIKUT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në 36-vjetorin e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut, u.d. presidentja Albulena Haxhiu së bashku me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti dhe zëvendëskryeministrin në detyrë Donika Gërvalla, mirëpritën disa nga delegatët e asaj kohe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për t'i nderuar dhe për të kujtuar një nga aktet më të rëndësishme në historinë tonë shtetformuese. "Më 2 korrik 1990, kur dyert e Kuvendit u mbyllën me forcë, delegatët e Kosovës nuk heshtën. Ata folën në emër të popullit edhe jashtë sallës, duke dëshmuar se legjitimiteti buron nga vullneti i qytetarëve. Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut ishte akti me të cilin Kosova refuzoi nënshkrimin dhe artikuloi qartë të drejtën e saj për vetëvendosje", ka thënë Haxhiu. Ajo ka theksuar se ky akt u bë gurthemel në rrugën drejt

Republikës së Kosovës. "Pas tij erdhën Kushtetuta e Kaçanikut, referendumi për pavarësi, organizimi institucional i viteve '90, lufta çlirimtare e UÇK-së dhe, më në fund, shpallja e pavarësisë. Ishte një rrugë e gjatë, e ndërtuar me vizion, qëndresë dhe sakrificë. Sot i nderojmë me mirënjohje delegatët e 2 korrikut dhe të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e themeleve të Republikës sonë. Akti i tyre na rikujton se liria, shtetësia dhe sovraniteti mbrohen çdo ditë, me institucione të forta dhe me përkushtim ndaj vullnetit të qytetarëve", është shprehur Haxhiu.

Ndërkaq kryeministri Kurti tha se Deklarata Kushtetuese ishte shprehje e lirisë, por edhe e barazisë, ishte shprehje e vullnetit të popullit kundër diskriminimit e nënperfaqësimit.

Duke përmendur edhe Kushtetutën e 7 Shtatorit në Kaçanik, ai theksoi se "këto dy akte politike, të cilat e



përplotësuan njëra-tjetrën, ishin shpallje deklarative politike, por edhe shpallje normuese e juridike të Kosovës republikë, si një vullnet politik gjithëpopullor e i kamotshëm, i cili deri atëherë ishte qarkulluar masivisht, por vetëm si një parullë". "Më 2 korrik 1990, vullneti legjitim politik i shqiptarëve triumfoi

mbi dhunën, shtypjen dhe diskriminimin politik të Serbisë ndaj tyre. Republika e Kosovës, e shpallur në vitin 1990, ishte e para republikë e Kosovës, e cila rezultoi të ishte republikë për rezistencë, njëherë për qëndresë paqësore e mandej edhe për luftë çlirimtare", tha kryeministri.

Duke iu drejtuar delegatëve të pranishëm, kryeministri në detyrë Kurti tha se takimi në përvjetorin e 36-të të Deklaratës është falënderim e mirënjohje ndaj tyre dhe përpjekje për të kultivuar një traditë institucionale të njohjes së vlerave, kontributeve dhe historisë.

ZULFAJ: KOSOVA PRITET T'I HUMBË MBI 40 MILIONË EURO NGA PLANI I RITJES

PRISHTINË, 2 KORRIK - Për shkak të moszbatimit të reformave me kohë, Kosova pritet të humbasë mbi 40 milionë euro nga Plan i Rritjes i Bashkimit Evropian. Kryenegociatori i Kosovës me BE-në, Jeton Zulfaj, në një konferencë për media, tha se gjashtë hapa nuk u zbatuan deri në afatin shtesë që skadoi më 30 qershor. "Për hapat që nuk kanë arritur të përfundohen në periudhën shtesë, mjetet e dedikuara për përfundimin e tyre humbin. Nga 13 hapat që kishin afat shtesë deri më 30 qershor, shtatë konsiderohen të zbatuar, ndërkaq gjashtë nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht. Nga këta gjashtë hapa, ka zbatim në disa nënhapa. Kostoja llogaritet të jetë mbi 40 milionë euro. Vlera e saktë do të përcaktohet nga Komisioni Evropian, varësisht nëse do t'i llogarisë edhe nënhapat e zbatuar", tha Zulfaj.



Nga Plan i Rritjes, që përfshin periudhën 2024 - 2027 në vlerë prej 6 miliardë eurosh, Kosovës i takojnë rreth 882 milionë euro - 253 milionë si grante dhe 629 milionë euro në formë të kredisë. Vendi është përfitues më i madh nga ky fond në rajon për kokë banori. Zulfaj tha se reformat që nuk u

përmbyllen me kohë kanë të bëjnë me një sërë ligjesh që duhen të miratohen nga Kuvendi, përfshirë Ligjin për energjinë dhe atë për energjinë elektrike, për sistemin e kontrollit të ndihmës shtetërore, Ligjin për inovacion, atë për kamatëvonesat, pakon e ligjeve për reforma në drejtësi që, sipas

tij, përfshin gjashtë ligje, përfshirë ato për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe atë Gjyqësor si dhe Strategjinë për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

Kryenegociatori i Kosovës me BE-në tha se nga gjashtë reformat e pazbatuara, pesë prej tyre kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve apo 83 për qind kanë të bëjnë me miratimin e ligjeve në Kuvend. "Me fjalë të tjera, pothuajse të gjitha hapat që nuk kanë arritur të zbatohen janë si pasojë e bllokadës dhe mosfunksionimit të Kuvendit", tha ai.

Agjenda e reformave përfshin 111 hapa me akte nënligjore që përfshijnë rreth 300 nënhapa të tjerë.

Kosova aktualisht është me ekzekutiv në detyrë, pasi vendi mbajti zgjedhje të parakohshme parlamentare më 7 qershor dhe rezultati zgjedhor ende nuk

është certifikuar. Vitin e kaluar, Kosova organizoi dy palë zgjedhje, në shkurt - që ishin të rregullta - dhe më pas në dhjetor, pasi nuk kishte konsensus për krijimin e institucioneve.

Vetëm pas certifikimit të rezultateve të 7 qershor hapet rruga për formimin e institucioneve të reja.

Zulfaj në konferencën për media tha po ashtu se edhe 49 hapa të tjerë janë në zbatim e sipër, përfshirë 27 prej tyre që kanë afat për zbatim deri në fund të këtij viti.

Në prill, Kosova përfitoi pjesën e parë të fondeve të parafinancimit, duke marrë 61.8 milionë euro, pasi shteti dorëzoi dokumentet e nevojshme në KE dhe ratifikoi marrëveshjet e lidhura me këtë plan.

Ky plan i BE-së, veç tjerash, synon të dyfishojë ekonomitë e këtyre vendeve gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

ASK-ja prezanton për herë të parë parashikimet e popullsisë në nivel komune

PRISHTINË, 2 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportet: Parashikimet e popullsisë dhe profilet e komunave të Kosovës.

Të dhënat janë bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave (ReKos 2024) përfshirë edhe ato të vitit 2011. Për publikimin e këtyre raporteve u organizua një Konferencë ndërkombëtare, ku morën pjesë përfaqësues të lartë të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të lartë të Organizatave të

Kombeve të Bashkuara, përfaqësues të lartë të ambasadave dhe organizatave të huaja në Kosovë, ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, kryetarë të komunave dhe të tjerë.

Këto dy publikime dallohen edhe për nga risia që sjellin. Për herë të parë, parashikimet e popullsisë janë realizuar edhe në nivel komune.

Po ashtu, profilet e komunave publikohen për herë të parë në Kosovë me një qasje të tillë të detajuar statistikore, duke ofruar të dhëna të strukturuar dhe

gjithëpërfshirëse për secilën komunë. "Në total, janë përgatitur: 2 812 grafikone, 304 tabela statistikore, 152 harta tematike m gjithsej 1 254 tregues statistikorë. Veçanërisht, hartimi i profilit për 38 komuna, ku secila komunë është trajtuar veçmas me treguesit e saj demografikë, socialë dhe ekonomikë, ka qenë një proces jashtëzakonisht voluminoz dhe kërkues", u tha në hapje të konferencës.

Për secilin profil janë bërë analiza të detajuara të të dhënave që pasqyrojnë në mënyrë të qartë karakteristikat



dhe zhvillimet e secilës komunë. Drejtori i ASK-së, Avni Kastrati prezantoi parashikimin e

popullsisë së Kosovës 2025-2060. Kurse, profilet e komunave u prezantuan nga Idriz Shala.

Basha takon përfaqësuesit e Ambasadës Gjermane, diskutohen projektet infrastrukturore

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në vazhdim të takimeve me përfaqësues të shteteve partnere, ministri në detyrë i Infrastrukturës dhe Transportit, Dimal Basha, priti në takim Daniel Alker, Shef i Bashkëpunimit për Zhvillim në Ambasadën e Republikës Federale të

Gjermanisë në Kosovë, i shoqëruar nga Islami, përfaqësues i Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Sipas njoftimit për media, thuhet se gjatë këtij takimi u diskutua për ecurinë e investimeve që janë në implementim e sipër, me fokus të veçantë në projektet

infrastrukturore që po zhvillohen me mbështetjen e partnerëve gjermanë, ndërkaq në vijim të bisedës i njoftova me prioritetet dhe planet tona në fushën e infrastrukturës, të cilat synojnë modernizim, rritje të sigurisë dhe zgjerimin e lidhjeve brenda vendit si dhe me rajonin e Evropës

Juglindore. Bashkëpunimi me institucionet gjermane dhe me shtetin gjerman në përgjithësi është aset i çmuar për vendin tonë në kuadër të lidhjes së veçantë mes nesh, për çfarë jemi të lumtur dhe të interesuar ta ruajmë e ta kultivojmë me kujdes.



AGJENCIA PËR PRONËSI INDUSTRIALE SHËNON RITJE TË REGJISTRIMEVE DHE AVANCIM TË DIGJITALIZIMIT

PRISHTINË, 2 KORRIK - Agjencia për Pronësi Industriale, në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ka përmbyllur gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 me rezultate të rëndësishme në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, avancimin e procesit të digjitalizimit dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke forcuar më tej sistemin e pronësisë industriale në Republikën e Kosovës. Statistikat e periudhës janar - qershor 2026 dëshmojnë një rritje të konsiderueshme të performancës së Agjencisë.

Numri i regjistrimeve të markave tregtare është rritur nga 837 në 1,163, ose 38.95% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Po ashtu, ekzaminimet e markave tregtare janë rritur me 12.45%, certifikatat e regjistrimit me 18.22%, ndërsa vazhdimet e regjistrimit të markave tregtare

me 28.88%.

Edhe të hyrat e Agjencisë kanë shënuar rritje, duke arritur në 206,715 euro, ose 6.2% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2025.

Një nga treguesit më domethënës është edhe shkurtimi i kohës së procedurës së regjistrimit të markave tregtare.

Në krahasim me vitin 2024, koha mesatare e regjistrimit është zvogëluar për gati tre muaj, duke reflektuar efikasitet më të madh administrativ dhe ofrim më të shpejtë të shërbimeve për bizneset dhe qytetarët.

Një arritje tjetër strategjike gjatë kësaj periudhe është përfundimi me sukses i migrimit në IPAS 4.0, versioni më i avancuar i sistemit të administrimit të pronës industriale të mbështetur nga WIPO. Ky sistem krijon bazën teknike për ofrimin e shërbimeve online si pjesë e procesit të digjitalizimit të plotë të Agjencisë. API-ja ka shënuar progres të



rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e sistemit të pronësisë industriale.

Është dakorduar në parim Marrëveshja Teknike e Bashkëpunimit me Zyrën Austriake të Patentave, e cila pritet të formalizohet së shpejti. Përmes kësaj marrëveshjeje do të krijohet një shërbim krejtësisht i ri për inovatorët dhe aplikuesit në Kosovë, duke mundësuar ekzaminimin substancial të patentave nga ekspertët e Zyrës Austriake të Patentave. Ky bashkëpunim do të rrisë cilësinë e procedurave të patentimit, do të

fuqizojë besueshmërinë e sistemit dhe do t'u ofrojë shpikësve në Kosovë qasje në ekspertizë të avancuar evropiane. Gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka forcuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë përmes përfshirjes në projektin rajonal EU4IP - Strengthening Intellectual Property Rights in the Western Balkans, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga EUIPO, si dhe avancimit të përgatitjeve për zbatimin e programit Swiss PartnersHIP - Kosovë, të mbështetur nga Qeveria Zvicerane.

Këto iniciativa do të kontribuojnë në forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale në Kosovë, përmes përafrimit të legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian, ngritjes së kapaciteteve institucionale, zhvillimit të ekosistemit të inovacionit dhe mbështetjes së mbrojtjes së produkteve vendore me tregues gjeografikë.

Krahas këtyre zhvillimeve, gjatë kësaj periudhe u publikua edhe libri "Markat Tregtare në Kosovë - Analizë e Parimeve Kryesore përmes Praktikës së Agjencisë për Pronësi Industriale", botuar nga Vokshi & Lata Law Firm.

Libri paraqet analizën e parë të praktikës administrative të Agjencisë dhe shërben si një referencë e rëndësishme për bizneset, profesionistët dhe institucionet, duke kontribuar në rritjen e sigurisë juridike, transparencës dhe unifikimit të praktikës në fushën e markave tregtare.

Arritjet e realizuara gjatë kësaj periudhe dëshmojnë progresin e Agjencisë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, avancimin e digjitalizimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e një sistemi modern dhe të besueshëm të pronësisë industriale në Republikën e Kosovës.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME MORI PJESË NË KONFERENCËN "MBËSHTETJA E BE-SË NDAJ BALLKANIT PERËNDIMOR"

PRISHTINË, 2 KORRIK - Në kuadër të vizitës në Gjykatën Evropiane të Auditorëve në Luksemburg, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, me bashkëpunëtorë mori pjesë në konferencën e organizuar nga ky institucion me temën "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor".

Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe autoriteteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të diskutuar mbi efektivitetin e

instrumenteve kryesore financiare të BE-së që mbështesin zhvillimin dhe procesin e integritetit evropian të rajonit.

Diskutimet u fokusuan në funksionimin e Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework - WBIF), si dhe në zbatimin e Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor (Reform and Growth Facility).

Pjesëmarrësit trajtuan progresin e arritur, sfidat në



zbatim dhe rëndësinë e forcimit të qeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies për të siguruar përdorimin sa më efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian. Auditorja e Përgjithshme, duke vlerësuar lartë rëndësinë e kësaj konference dhe ndihmën evropiane për Ballkanin Perëndimor shpallosi para pjesëmarrësve rolin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditimin e projekteve të financuara nga BE, duke ofruar shembuj konkret të angazhimit të institucionit.

Konferenca ofroi gjithashtu një

mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e qasjeve të auditimit në vlerësimin e ndikimit të mbështetjes financiare të BE-së, duke krijuar një bazë të vlefshme për bashkëpunim dhe zhvillimin e auditimeve të ardhshme në këtë fushë.

Në kuadër të konferencës, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, zhvilloi takime të veçanta me anëtarin e Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Laima Andrikiene, si dhe me deputetin e Parlamentit Evropian, Thomas Waitz.

Infrakos kërkon respektim të brezit të sigurisë pranë hekurudhës Fushë Kosovë - Pejë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ndërmarrja "Infrakos" ka njoftuar opinionin publik, operatorët ekonomikë dhe të gjithë përdoruesit e rrugëve që kryqëzojnë linjën hekurudhore Fushë Kosovë - Pejë, për rëndësinë e respektimit të rregullave të sigurisë pranë infrastrukturës hekurudhore.

Sipas njoftimit, në këtë linjë janë të instaluar lura automatike në vendkalimet hekurudhore, të cilat funksionojnë përmes një sistemi sensorësh me qëllim

garantimin e sigurisë në trafikun hekurudhor dhe atij rrugor. "Infrakos Sh.A njofton qytetarët, operatorët ekonomikë dhe të gjitha palët e interesit se në linjën hekurudhore Fushë Kosovë - Pejë janë të instaluar lura automatike në vendkalimet hekurudhore, të cilat funksionojnë përmes një sistemi automatik të sensorëve dhe kanë për qëllim garantimin e sigurisë së trafikut hekurudhor dhe atij rrugor. Me këtë rast,

Infrakos Sh.A u bën thirrje të gjithë përdoruesve të rrugëve, operatorëve të makinerive punuese dhe çdo pale tjetër që gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre të respektojnë brezin e sigurisë pranë trupit të hekurudhës dhe të mos afrohen më pak se 3 (tre) metra nga trupi i binarit, përveç rasteve kur janë të autorizuar dhe punimet zhvillohen në koordinim me autoritetet përgjegjëse. Respektimi i kësaj distance është

i domosdoshëm për funksionimin e sigurt dhe të pandërprerë të sistemit automatik të vendkalimeve hekurudhore, si dhe për garantimin e sigurisë së trafikut hekurudhor dhe atij rrugor", është thënë në njoftimin për medie, duke theksuar se çdo mosrespektim i brezit të sigurisë pranë infrastrukturës hekurudhore do të monitorohet përmes sistemit të kamerave dhe në rast të konstatimit të



shkeljeve, do të ndërmerren veprimet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë edhe raportimin e rasteve te organet kompetente.

ÇFARË PO NDODHË NË SHQIPËRI? (2)



Shkruan: Hajdin ABAZI

Protestat në Shqipëri po vazhdojnë, flamingot po e ruajnë dinjitetshëm durimin dhe reagimin qytetar në linjat paqësore, gjë që po i bën tepër të veçanta, tashmë edhe në ditën e 32-të. Revoltat e mëdha qytetare zakonisht ose ndodhin për një kohë të shkurtë ose degradojnë në përlëshje. As njëra e as tjetra nuk po ndodhin. Madje, ka një tendencë zgjerimi edhe në qytete të tjera, duke treguar se jo vetëm figurativisht por edhe realisht pakënaqësia është kombëtare.

Kah po ecin zhvillimet?

Mundësia e infiltrimeve, çka edhe ka gjasa të jetë ashtu sikurse thuhet, nuk është assesi shkaku kryesor, e aq më tepër duke stisur agjentë e duke përhapur dyshime, gjë që shpërfaqet dobësia e pushtetit - ku ishte më herët, përse nuk ka reaguar me kohë, përse nuk ka vepruar për t'i kapur dhe për t'i vënë para drejtësisë? Një masë e duhur u ndërmor ndaj disa elementeve të hapura pro-iranianë - këta as nuk ishin e as nuk janë forca shtytëse, po vetëm dëmtuese. Shqipëria nuk ka aspirata religjioze, po politike, sociale, ekonomike, të mirëqenies, të dinjitetit njerëzor, të mos nëpërkëmbjes së krenarisë shqiptare, mos tjetërsimit të atdheut.

Në shikim të parë duket sikur dita është e pushtetit, e proceseve të zakonshme administrative e të funksionimit të shtetit; kurse mbrëmja është e protestuesve, e të pakënaqurve. Ndonëse, herë-herë, po ka zhvillime edhe gjatë ditës, kur protestuesit, në lokalitete të ndryshme kur vazhdojnë abuzimet, me vigjilencë reagojnë për të treguar se këtu jemi. Ndjenja e reagimit për ato zona që janë mbrojtur edhe me ligj, vetëm sa është forcuar. Abuzuesit nuk do ta kenë më rehatinë që e kishin ndër dekada. Shtetit e atdheut po i dilet zot nga qytetarët,

ndërkohë që pushteti bëhet i shurdhër dhe memec. Abuzimet janë damkosur dhe janë kthyer në një të keqe kombëtare.

Admirimi nga perëndimorët, sidomos nga evropianët, për natyrën e protestës së masave të gjeta popullore po rritet dhe po merr vëmendjen e qendrave të vendosjes. Disa syresh po dalin edhe hapur në mbështetje: deputetë europarlamentarë dhe nga Parlamenti Evropian. Po ju japin të drejtë. Sigurisht, ky nuk është thelbi, po është tregues se revolta qytetare ka për bazë vlerat perëndimore, të cilat janë vlera edhe për shqiptarët. Sidomos tepër i veçantë është durimi dhe karakteri paqësor i protestës edhe për 32 ditë radhazi, sjellja e dinjitetshme e protestuesve, të cilët kanë guximin të dalin, të protestojnë, të targetojnë fenomenet negative që e kanë gërryer shtetin dhe atdheun shqiptar, por po ashtu janë krejtësisht të ndërgjegjshëm se ata nuk duan shkatërrim, nuk duan rrënim, nuk duan dhunë, nuk duan përlëshje, nuk duan luftë midis shqiptarësh, nuk duan gjakderdhje. Deri tash ishte kështu, dhe kjo është madhështore. Duket se ky brez ka nxjerrë mësimet e duhura nga e kaluara se dhuna nuk është mjeti i duhur, jo përderisa ka hapësirë për veprim demokratik. Ajo që do të japë rezultat është qëndrueshmëria, vazhdimi dhe mos reshtja e protestave: ashtu dinjitetshëm, me krenari, me dashuri ndaj atdheut e ndaj shtetit.

A është kjo e mundur?

Historia tregon se po. Dhe shembulli më flagrant, që ka frymëzuar gjithandej nëpër botë lëvizjet paqësore, është rezistenca e organizuar nga Mahatma Gandhi. Ai ndër të parët që e zbuloi se forca e popullit nuk qëndron vetëm te përlëshjet, te kacafytjet, te konflikti, te lufta civile ose lufta e armatosur e frontale. Ai e zbuloi, dhe i dha mësim njerëzimit, se forca e një populli po aq qëndron edhe te

vetëdija për fuqinë e vet, te vendosmëria për ndryshimin, te qëndrueshmëria, te mos thyerja e mosdorëzimi, po te vazhdimi dhe te shpërfaqja e kërkesave reale, thelbësore që e ngulfasin një popull, shtetin e atdheun.

Ndryshimet e mëdha, ashtu sikurse sëmundja e kancerit nuk ka terapi efektive të shpejtë, jo në këto rrethana, jo në këtë gjendje kur Shqipëria ndodhet në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. As gjendja evropiane e as ajo ndërkombëtare nuk është në favor të situatës revolucionare. Konform kësaj, alternativa e vetme mbetet vazhdimi në mënyrë paqësore të protestohet, të shprehet pakënaqësia me pushtetet që për tridhjetë e pesë vite nuk kanë arritur t'i ndalin abuzimet kancerogjene të shtetit, të atdheut e të dinjitetit dhe krenarisë kombëtare të shqiptarëve, po vetëm i kanë ekspanduar. Populli ka shpërfaqur guximin qytetëruar. Ky është dallimi, por edhe avantazhi i madh i protestave të tashme qytetare.

Përderisa marshimet e protestat janë paqësore, në botën virtuale, në rrjetet sociale zhvillohet një luftë mjaft epike. Në njërën anë paraqiten folës të ndryshëm, që shpesh duken të rastit, dhe mbajnë fjalime frymëzuese përmes rasteve personale ose specifike, duke treguar për korrupsionin, për shkelje të ndryshme ligjore, për përvetësim me qindra miliona nga pasuria kombëtare, me dëshmi nga ndjekjet penale të SPAK-ut, apostrofohen emra konkret, duke u distancuar nga garniturat famëkëqija të korrumpuara politike të 35 viteve të kaluara, por gjithnjë duke manifestuar dashuri ndaj atdheut, kombit, historisë, madje edhe duke u treguar ambientaliste - duke pastruar rrugët e sheshet pas protestave. Ia drejtuan "Albanian files" SPAK-ut për ta faktikuar skemën e abuzimeve e që pretendohet se ato po implementohen.

Në anën tjetër është pushteti,

sidomos numri një i tij, që është tejet aktiv në rrjetet sociale me kundërvënien virtuale. Sharmi, afiniteti komik dhe përcmimi po kthehen në bumerang. Duket se nuk po kuptohet drejt gjendja reale e masave që po protestojnë. Nuk bëhet shaka me masat më të ndërgjegjshme të popullit. Jo rrallë del kontradiktor. Angazhohet ta vërë partinë në konfliktin virtual. Ndonëse protestat nuk kanë të bëjnë me partitë, me anëtarësinë e gjerë, por vetëm me ata që brenda tyre abuzojnë me shtetin e pasuritë kombëtare. Duket se edhe brenda partive të vjetra, të mëdha, ka pakënaqësi ndaj liderit dhe po shfrytëzohet gjendja për t'u artikuluar dhe ri-pozicionuar. Duket se godinat e vjetra nuk mund të mbahen më, pa një rinovim të mirëfilltë. Dhe duket se këtë e kanë kuptuar disa.

Porse problemi i vërtetë nuk është as produkt e as shkak virtual, i rrjeteve sociale. Ai është real, i brendshëm, në ingranazhet e shtetit nga qeveria qendrore e deri te pushteti lokal. Korrupsioni. Abuzimet. Privatizimi i segmenteve të atdheut. Nëpërkëmbja e dinjitetit njerëzor të shqiptarëve. Zhvatja thuaja publike e buxhetit të shtetit dhe e thesareve të atdheut. Një gërmadhë padrejtësisht ndaj qytetarëve. Premtimet e dhëna e shkelja e tyre. Mashtrimet, Gënjeshttrat publike. Shpërfillja e vullnetit të qytetarëve.

E pra, atdheu nuk është vetëm i disave, po i të gjithëve. Kjo duket se është harruar nga garniturat pushtetare në këto 35 vite.

Shteti nuk është një e mirë vetëm për kastat në pushtet, por duhet të jetë një e mirë e përgjithshme, për të gjithë qytetarët pa dallim. Drejtësia duhet të jetë e paanshme dhe gjithherë të anojë në anën e atyre që kanë të drejtë, e jo të atyre që janë të fortë.

Dikur besohej se Shqipëria ishte e varfër dhe shpëtimi

kërkohej në emigrim, por doli se Shqipëria ishte e pasur sepse garniturat e establishmentit të deritanishëm kanë abuzuar me miliarda euro ndërkohë që masat e gjera qytetare varfërohen. Këto tashmë po dëshmojnë edhe nga SPAK-u. Po si u bë që në çdo palë zgjedhje, gjithherë betoheshin e përbetoheshin se do të punonin për të mirën e Shqipërisë, për qytetarët e saj dhe mirëqenien e tyre, e gjithnjë bënë minimumin për këto - e maksimumin për ato që nuk i thoshin: përvetësim korruptive parash, pronash, vilash, banesash e depozitime jashtë vendit. Dhe nuk kishin që nuk kishin të ngopur.

Këto të këqija që i janë rënduar masave të gjera qytetare; këto janë ato problemet reale, të cilat masat protestuese po kërkojnë ndalimin e tyre, dhe bëjnë shtetit një të mirë të përgjithshme për shtetasit (ashtu sikurse e kishte definuar Aristoteli). E pushteti i establishmentit të këtyre duket se është e pamundur të bëjë ndryshimin, është absorbuar dhe është kapur në rrjetin e ushujzave të pangopshme.

Të gjitha këto janë motive, pjesëza të mozaikut qytetar të pakënaqësisë, që i bëjnë qytetarët të revoltohen, të protestojnë, të tregojnë se nuk durohet kjo gjendje më.

Si rrjedhojë, ka pasur disa momente kur gjendja është agravuar.

Fodullëku i disa pushtetarëve, vazhdimi me komoditet dhe injorimi thuaja total i masave të mëdha qytetare nga ana e disa pushtetarëve, ka acaruar nervat e disa protestuesve. Ata nisën të reagonin duke hedhur vezë e shishe plastike uji në drejtim të veturave të tyre.

Kjo e vë në hall policinë e rendit. Ajo duhet t'i mbrojë të gjithë qytetarët pa dallim, dhe vepron për të ndaluar përlëshjet. Deri më tash e ka bërë pa përdorë dhunë, dhe kjo është shenjë e mirë. Madje, edhe kur i arrestoi disa nga protestuesit, ishin tejet të kujdesshëm. Konflikti me policinë duhet të mos ndodhë.

Disa nga organizatorët e thonë këtë, dhe duhet t'i përmbahen. Gjaku shqiptar nuk ka përse të derdhet, nga askush.

Nuk është zgjidhja te heroizmat e Avni Rustemit, sepse sistemi nuk ndryshohet ashtu, nga që nuk është një individ, po është një garniturë, dhe shpejt mund të zëvendësohet individ nga kjo garniturë. Për garniturën abuzuese politike nuk çon peshë aspak emri i individit, por qasja abuzive të pushteti, te thesari i shtetit dhe i atdheut. Një gabim të tillë nuk do të duhej ta bënte askush në Shqipëri. Një garniturë e degraduar mund të mposhtet vetëm me ndryshime kualitative, duke demonstruar forcën e popullit përmes vazhdimit dhe qëndrueshmërisë së mbrojtjes së Shqipërisë.

Pushteti po e vë theksin te infiltrimet dhe spiunazhi i huaj, gjë që nuk përjashtohet si mundësi, por që bëhet për të ngjallë hutë, mosbesim, dyshim e zhgënjim. Një gjë e mirë është se pushteti nuk ka treguar deri më tash ndonjë prirje për të provokuar përmes nxitjes së dhunës policore (se a po ndodhë kjo nga që policët nuk do ta përfillnin një urdhër të tillë ndaj demonstruesve paqësor dhe mund të

braktisnin uniformat e të dilnin në anën e popullit; apo është përmbajtje e pushtetit; apo një kombinim i të dyjave - mbetet ta tregojë koha). Sido që të jetë, kështu duhet të vazhdojë. Sepse policët janë të këtij populli dhe nuk bën, në asnjë mënyrë të vihen kundër popullit të vet. Por edhe protestuesit duhet të mos veprojnë ashtu që të cenojnë sigurinë e institucioneve, nga që ata duhet të reagojnë për t'i mbrojtur ata.

Sigurisht, pushteti ka disa përgjegjësi kushtetuese e ligjore. Nuk mundet të bie lehtë asnjë pushtet. Ai duhet të tregojë qëndrueshmëri institucionale. Duhet të sprovohet në raport me protestuesit. Dhe vetëm kur i pamundësohet qeverisja pak a shumë normale, atëherë duhet kërkuar zgjidhje. Nga Bashkimi Evropian po i bëhen thirrje pushtetit që t'i përfillë demonstruesit, kanë shprehur mbështetje për disa nga kërkesat e tyre. Duhet të reflektohet nga pushteti, por edhe nga demonstruesit, sidomos nga organizatorët.

Çfarë duhet të kuptojë pushteti që nuk e ka kuptuar deri më tash?

Pushteti duhet të kuptojë se kontratën që e ka bërë me


qytetarët (përmes zgjedhjeve të fundit parlamentare) nuk e ka përmbushur. Ajo nuk ka qenë kontratë që të ndryshon ligjet për të mundësuar tjetërsimin e zonave të mbrojtura dhe perlat shqiptare. Ajo nuk ka qenë kontratë që të shiten copëza të atdheut pa transparencë dhe kundër ligjeve; sepse kur shiten një fragment atdheut - blerësi mund t'ia shesë nesër kujt të dojë dhe shteti nuk mundet më ta ndalojë - e mund të krijohen enklava që do të ishin kancerogjene për autoktoninë shqiptare! Ajo nuk ka qenë kontratë që shteti të bëhet hambar i abuzuesve dhe i zhvatësve, apo jo!? Nuk ka qenë kontratë për të vazhduar e thelluar korrupsionin! Nuk ka qenë kontratë për të degraduar masat qytetare shqiptare! Nuk ka qenë kontratë që pushteti të shndërrohet në sundim ndaj qytetarëve, po në shërbim të tyre. A mundet, vallë, t'i kuptojë pushteti këto largime nga misioni i përcaktuar me kontratën qytetare në zgjedhjet e kaluara? Do të duhej. Sepse, ndonjë punë e mirë e bërë ka mbetur nën hijen e të këqijave që po i ngulfasin masat qytetare. Po qe se pushtetarët i kanë dhënë vetes të drejtën aspak legjitime ta tjetërsojnë kontratën politike me elektoratin, atëherë populli ka të drejtën legjitime që t'i thotë

mjaft e të kërkojë një kontratë të re politike që shtetin do ta bënte shtet të së drejtës, që të zotërojë transparencë, që pushteti të luftojë abuzimet e të gjitha llojeve. Pushteti duhet të reflektojë e të gjejë mënyra për të vënë kontakt me protestuesit si institucion i popullit, ashtu që gjithçka të kanalizohet drejt kompromisit dhe gjetjes së modeleve për të ecur përpara. Po protestuesit dhe sidomos organizatorët, çfarë duhet të kuptojnë që të mos e humbin kauzën?

Masat qytetare po demonstrojnë paqësisht për ndryshimin real e jo mashtruese sikurse për tri dekada e gjysmë e kanë lozur lojën garniturat e establishmentit. Ky duhet të jetë tabani i tyre, i pandryshuar. Nëse njëmend duan ta ruajnë dinjitetin dhe të tregojnë shkëputjen nga praktikata e vjetra të agresivitetit. Ata kanë një platformë politike, për ndryshim në qeverisje. Forca e tyre reale nuk qëndron thjesht vetëm te masiviteti, po, mbi të gjitha, te kërkesat reale dhe legjitime, që Shqipëria t'i kthehet vetes e qytetarëve të saj. Po qe se aspiratat janë njëmend të këtitilla, atëherë organizatorët duhet të lidhen me figura të shquara intelektuale, me shkencëtarë, politologë, filozofë, ekonomistë, diplomatë, ish-ushtarakë e të këtillë. Ndër

shqiptarët ka emra eminentë, që kanë arritur ta ruajnë dinjitetin e vet dhe kanë treguar sukses me vepra e arritje. Pa i bashkuar këto kapacitete gjasat janë minimale të sendërtohen objektivat e vërteta qytetare. Euforia duhet për ta mbajtur gjallë protestën, për të treguar vendosmërinë që është kusht për ta mundësuar ndryshimin e kërkuar kualitativ, porse për sendërtimin e saj nevojitet një elitë serioze, e aftë për t'u përballur me sfidat dhe për t'i bartur proceset pozitive drejt anëtarësimit në BE. Duhet të dalë një elitë me vlera të dëshmuara, me frymë perëndimore, e jo të merren si model që konfiktohet me perëndimoret, sepse atëherë do të dëmtohej Shqipëria dhe protestat do të ktheheshin në të kundërtën e vet. Deri këtu, protestat e kanë kryer si duhet misionin e vet: e kanë qartësuar ndryshimin rrënjësor në politikë që i duhet Shqipërisë. Tash duhet të kalojë në fazë tjetër: të bashkojë kapacitetet intelektuale të ndershme, me moral, me dinjitet, me virtyte, patriotë me shpirt e mendje; ta bëjë një alternativë që njëmend të jetë e aftë për ta bërë ndryshimin, për ta kuruar shtetin shqiptar nga sëmundjet e së kaluarës.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Prattipati nderohet me fanellën e Kosovës me numrin 250 nga FFK-ja

PRISHTINË, 2 KORRIK - E ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Anu Prattipati është nderuar me një fanellë të ekipit

kombëtar të Kosovës me numrin 250, për nder të 250-vjetorit të Pavarësisë së ShBA-së. Përmes një njoftimi, Ambasada amerikane në Kosovë falënderoi Federatën e

Futbollit të Kosovës për këtë gjest simbolik, duke e cilësuar atë si një shprehje të miqësisë së fortë ndërmjet dy vendeve. "Faleminderit Federata e Futbollit të Kosovës për këtë

gjest domethënës dhe për festimin e miqësisë së qëndrueshme midis dy vendeve tona", ka njoftuar Ambasada e ShBA-së në Kosovë.



ADEMI URON GAZETARËT SPORTIVË: SË SHPEJTI DO TA JETOJMË SË BASHKU ËNDRRËN E BOTËRORIT APO EVROPIANIT

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar gazetarët sportivë me rastin e Ditës Botërore të Gazetarëve Sportivë, duke i falënderuar për përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e tyre në pasqyrimin e futbollit dhe sportit në Kosovë.

Në mesazhin e tij, Ademi ka theksuar rëndësinë e gazetarisë sportive, duke vlerësuar se ajo nuk është vetëm raportim i rezultateve apo i ngjarjeve, por edhe dokumentim i historisë dhe ndërtim i kujtesës kolektive të sportit. "Të nderuar gazetarë sportivë, me rastin e Ditës Botërore të Gazetarëve Sportivë, kam kënaqësinë që, në emrin tim dhe të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës, t'ju përcjell urimet më të përzemërta dhe t'ju falënderoj për përkushtimin, profesionalizmin dhe punën tuaj të vazhdueshme në pasqyrimin e futbollit dhe



sportit në vendin tonë. Gazetaria sportive nuk është vetëm raportim i rezultateve apo i ngjarjeve. Ajo është dokumentim i historisë, përcjellje e emocioneve dhe ndërtim i kujtesës kolektive të çdo suksesi, sfide e momenti që e shënon futbollin tonë", ka thënë Ademi.

Presidenti i FFK-së ka kujtuar emocionet që kanë shoqëruar futbollin kosovar në vitet e

fundit, duke theksuar se gazetarët kanë qenë gjithmonë pranë ekipeve dhe tifozëve. "Në vitet e fundit, së bashku kemi përjetuar shumë emocione. Kemi festuar fitore të rëndësishme, kemi përballuar zhgënjime, por mbi të gjitha kemi parë rritjen e vazhdueshme të futbollit të Kosovës. Ju keni qenë gjithmonë aty për t'i përcjellë këto momente me profesionalizëm,

duke i sjellë pranë tifozëve dhe opinionit publik", është shprehur ai.

Ademi ka rikujtuar edhe rrugëtimin e Kosovës drejt Kupës së Botës 2026, duke theksuar se përfaqësuesja ishte shumë pranë një arritjeje historike. "Sivjet ishim shumë afër realizimit të një ëndrrë të madhe. Ishim vetëm 90 minuta larg pjesëmarrjes në Kupën e Botës 2026. Kjo do të ishte një arritje historike dhe një krenari për popullin tonë, por njëkohësisht edhe një mundësi e jashtëzakonshme për ju, gazetarët sportivë, që ta përcillnit nga afër rrugëtimin historik të Kosovës në skenën më të madhe të futbollit botëror. Ndonëse kjo ëndërr mbeti për pak pa u realizuar, jam i bindur se dita kur Kosova do të jetë pjesë e një Botërori apo Evropiani nuk është e largët", është shprehur Ademi.

Në vazhdim, ai ka nënvizuar rëndësinë e mediave të lira dhe kritikës konstruktive, duke theksuar se ajo ndihmon në

avancimin e futbollit. "Shoqëria jonë ka nevojë për media të lira, profesionale dhe të përgjegjshme. Kritika e argumentuar dhe konstruktive është gjithmonë e mirëpritur, sepse na ndihmon të përmirësohemi dhe të ecim përpara. Por, po aq e rëndësishme është që puna, përkushtimi dhe sukseset të marrin vlerësimin që meritojnë", ka thënë Ademi.

Në fund të mesazhit, Ademi ka riafirmuar gatishmërinë e FFK-së për të vazhduar bashkëpunimin me mediet. "Federata e Futbollit të Kosovës do të vazhdojë të jetë partnere e mediave, duke kultivuar bashkëpunim, transparencë dhe respekt të ndërsjellë, me bindjen se vetëm së bashku mund të vazhdojmë ta zhvillojmë dhe ta promovojmë futbollin tonë. Ju falënderoj për angazhimin dhe pasionin që tregoni çdo ditë. Ju uroj shëndet, suksese në karrierë dhe sa më shumë momente të mëdha sportive!", ka thënë Ademi.

LOJTARËT E PREMIERLIGËS DOMINOJNË BOTËRORIN

NJU-JORK, 2 KORRIK - Futbollistët që aktivizohen në Premierligën angleze vazhdojnë të dominojnë skenën e Kupës së Botës 2026, duke konfirmuar edhe një herë statusin e kampionatit anglez si më i forti në futbollin botëror. Sipas të dhënave më të fundit, lojtarët e Premierligës kanë regjistruar gjithsej 106 kontribute në gola gjatë turneut, duke përfshirë gola të shënuar

dhe asistime. Kjo shifër është arritur pas fitores spektakolare të Belgjikës me rezultat 3-2 ndaj Senegalit pas vazhdimëve, ndeshje që ka shtuar edhe më shumë statistikat mbresëlënëse të futbollistëve që luajnë në elitën angleze. Ky total e vendos Premierligën qartësisht në krye të renditjes së kampionateve, duke lënë pas me diferencë të konsiderueshme ligat e tjera



evropiane dhe botërore për sa i përket ndikimit ofensiv në Botëror. Shumë prej yjeve më të spikatur të turneut janë pjesë e

klubeve angleze, ndërsa paraqitjet e tyre kanë qenë vendimtare në suksesin e kombëtareve respektive. Golat dhe asistimet e tyre kanë ndikuar drejtpërdrejt në kualifikimet dhe ecurinë e skuadrave në fazat eliminatorë.

Statistikat janë një tjetër dëshmi e cilësisë së jashtëzakonshme që ofron Premierliga, një kampionat që grumbullon

futbollistët më të mirë nga e gjithë bota dhe vazhdon të prodhojë protagonistët kryesorë edhe në skenën më të madhe të futbollit ndërkombëtar. Me fazën vendimtare të Botërorit ende në zhvillim, pritet që ky rekord të rritet edhe më tej, pasi shumë prej yjeve të Premierligës mbeten favoritë për të udhëhequr kombëtares e tyre drejt suksesit.

AKADEMIA E REFERIMIT HAP THIRRJEN PËR GJENERATËN E RE TË REFERËVE

PRISHTINË, 2 KORRIK - Akademia e Referimit e Kosovës ka hapur zyrtarisht thirrjen për gjeneratën e re të referëve, duke ftuar të gjithë të rinjtë dhe të rejtat që kanë pasion futbollin të bëhen pjesë e këtij rrugëtimi të rëndësishëm sportiv. Akademia e Referimit ofron mundësi për

zhvillim profesional dhe personal për të gjithë kandidatët që dëshirojnë të ndërtojnë karrierë në referim. Ky është hapi i parë drejt një rrugëtimi që mund të nisë nga fushat e futbollit në Kosovë dhe të vazhdojë deri në skenat më të mëdha evropiane dhe botërore.

Të interesuarit duhet të plotësojnë formularin e aplikimit dhe të bashkëngjijin dokumentet e kërkuara sipas udhëzimeve të përcaktuara. Afati për aplikim është nga 1 deri më 15 korrik, ndërsa dokumentet duhet të dërgohen në adresën elektronike: [kosova.com. Me këtë rast, Federata e Futbollit të Kosovës ka inkurajuar të gjithë të rinjtë që e duan futbollin dhe dëshirojnë të kontribuojnë në zhvillimin e tij, që të mos e humbin këtë mundësi dhe të bëhen pjesë e gjeneratës së re të referëve të futbollit të Kosovës.](mailto:akademiaereferimit@ffk-</p>
</div>
<div data-bbox=)



Komuna e Gjakovës
Opština Gjakovica
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr: 125
Data: 02.07.2026

**N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË**

KE: 0390/320 010
E-mail: nplsag@gmail.com
Info: 0390/324 268
Web:

SUI: 811444900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 1402000001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT – Nr.01/2024 për Regullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 pika 1,2 dhe 3 e Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve, pika 17 dhe 18 e nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Vendimit Nr.124 i datës 01.07.2026 U.D. Kryeshefi Ekzekutiv, N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A., Gjakovë, shpallë këtë:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

I.Pozita e punës: Laurist/ Porter

Numri i pozitave: 1(Një)

Kohëzgjatja e punës: Kohë të pacaktuar (ndërsa puna provuese në kohëzgjatje prej 6muaj)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Regjistron hyrje-daljet e autobusëve dhe mban evidence për emrin e firmës, relacionin dhe kohën e nisjes;
- Verifikon operatorët me rastin e lëshuarjes së objektit se a i kanë në rregull fletëlëshimet-biletën e paguar të peronizimit për relacionin në fjalë dhe në librin e posaqëm të evidencës të regjistroj kohën e daljes;
- Për punën e tij i përgjigjet shefit të stacionit.

Kualifikimet

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë pune;
- Të jetë i aftë për punë me presion dhe të ketë shkathtësi në kordinimin e punëve rutinore;
- Të jetë komunikues dhe të njoh ndonjë gjuhë të huaj
- Njohja e punës me programe kompjuterike përparësi

Dokumentacioni i kërkuar:

- Formular aplikimi i plotësuar;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional mbi shkollimin;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Kopjen e Letërnyfotimit;

• Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

II.Pozita: Biletar/e

Numri i pozitave 1(Një)

Kohëzgjatja e punës: Kohë të pacaktuar (ndërsa puna provuese në kohëzgjatje prej 6muaj)

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Grumbullon të hyrat nga transporti privat ndërurban;
- Grumbullon të hyrat nga transporti privat që kanë udhëtime jashtë shtetit të Republikës së Kosovës
- Dorëzon pazarin ditor çdo ditë të arkatari i ndërmarrjes;
- Kryen punë dhe detyra të tjera të caktuara nga Shefi Stacionit.
- Për punën e tij i përgjigjet Shefit Stacionit.

Kualifikimet:

- Përgaditje mesme shkollore;
- 1(një) vit përvojë pune e domosdoshme;
- Të jetë i aftë për punë në grup dhe të jetë bashkëpunues me operatorët e transportit privat;
- Shkathtësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Formular aplikimi i plotësuar;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional mbi shkollimin;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Kopjen e Letërnyfotimit;
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II. Stacioni i Autobusëve në Gjakovë dhe përmes postës elektronike në e-mail adresën zyrtare nplsag@gmail.com. Aplikacionet të dorëzohen në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

- Vlefshmëria për aplikim zgjat **30 Ditë** duke filluar nga data e publikimit të Konkursit, gjegjësishtë mbyllet me date **03.08.2025** ditë e Hënë në ora **16:00**.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues ose ndonjë mjet të disponueshëm kontaktues.

Vërejtje: Të cektet qartë titulli i vendit të punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Ev Wind Park" SH.P.K. Prishtinë, kërkesa me nr. prot. 26/3045/497/MMPH-DMM për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për Parku i energjisë me erë (35 MW) Zatriçi 1 në Zatriç, Rahovec, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 22.07.2026, në ora: 09:00, në hapësirat e Administrative të Kompanisë "EV Wind Park" në Fshatin Zatriq të Komunës së Rahovecit, do të organizohet debat publik nga operatori "Ev Wind Park" SH.P.K. Prishtinë, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me nr. prot. 26/3045/497/MMPH-DMM, për Parku i energjisë me erë (35 MW) Zatriçi 1 në Zatriç, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 216 652 4738

Passcode: 123123

Linku në zoom:

<https://us05web.zoom.us/j/2166524738?pwd=aJtauckjGTWwqBViEiFDw68ND03rzD.1>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"EV Wind Park" Sh.p.k.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Avril Solar" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812230770 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Avril Solar" D.O.O. Jakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812230770 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Avril Solar" L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812230770 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Olsa Burgjia shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 dhe 11 te shkollës "Loyola" Prizren.

- Gresa Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesën e klasës se 11-te te shkollës "Loyola" Prizren.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl, 6-9 të sh.m.u. "Rudolf Walther" Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë "Luciano Motroni" Prizren.

- Adizo SH.PK. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 81186552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

